



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 (1) të Rregullores së Kuvendit, në Seancën e plenare të mbajtur më 18 dhe 26 prill 2018, pas interpelancës së zhvilluar me ministrin e Shëndetësisë, z. Uran Ismajli në lidhje me sistemin informativ shëndetësor dhe sigurimet shëndetësore publike e private në Republikën e Kosovës, me propozim të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe në harmonizim me grupet tjera parlamentare GP LDK, GP PDK, GDP, GP AAK, GP NISMA dhe GP “6+”, miratoi këtë:

REKOMANDIME

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë me funksionalizimin dhe shtrirjen e plotë të Sistemit Informativ Shëndetësor dhe të bëjë publik kalendarin e aktiviteteve.
2. Qeveria e Kosovës të implementojë të 22 masat e rekomanduara nga Raporti i Auditorit të Përgjithshëm “Efikasiteti dhe efektiviteti në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor” Dhjetor 2017.
3. Qeveria e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, Oda e profesionistëve shëndetësorë dhe SHSKUK të hartojë dhe përgatisë parakushtet për Sistemin Informativ Shëndetësor ku përfshihen:
 - a. Lista e shërbimeve në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor në Kosovë në institucionet publike e ato private.
 - b. Kontrolli e më pas licencimi i të gjithë profesionistëve shëndetësorë që i plotësojnë kushtet, në sektorin publik dhe atë privat.
 - c. Krijimi i regjistrit shtetëror të punonjësve shëndetësore në të gjitha institucionet publike dhe private.
 - d. Ndërtimi i Sistemit të referimit të pacientëve.
 - e. Hartimi dhe zyrtarizimi i Udhërrëfyesve klinikë.
 - f. Regjistri shtetëror i barnave.
4. Kuvendi i Kosovës i kërkon Bankës Qendrore të Kosovës të paraqesë jo më vonë se 60 ditë pune Raport të detajuar mbi financat dhe operacionet e Kompanive të Sigurimit të licencuara të cilat ofrojnë dhe sigurimet private shëndetësore.

5. Qeveria e Republikës së Kosovës bazuar në raportin e performancës së Auditorit të përgjithshëm të adresojë në institucionet e drejtësisë rastet e shkeljeve dhe të dëmit financiar nga mos implementimi në kohë i Projektit për Sistemin Informativ Shëndetësor.

Do-630

Prishtinë, 26.04.2018

Kryetari i Kuvendit


Kadri VESELI

Mocioni u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve Parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

VI Saziv

Prolećno zasedanje

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova i člana 6 (1) na plenarnim sednicama od 18 i 26 aprila 2018, nakon interpelacije sa ministrom zdravlja g. Uran Ismajli u vezi informativnog javnog i privatnog zdravstvenog sistema u Republici Kosovo, na predlog PG – Samoopredeljenje i usaglašavanja sa drugim parlamentarnim grupama PG LDK, P GPDK, GDP, PG AAK, PG NISMA i PG “6+”, usvojila je sledeće:

PREPORUKE

1. Vlada Republike Kosova da započne funkcionalizacije i puno obuhvatanje informativnog zdravstvenog sistema i da objavi kalendar aktivnosti .
2. Vlada Kosova da sprovede 22 mere preporučena u Izveštaju Generalnog revizora „Efikasnost i efektivnost implementacije jedinstvenog integrisanog zdravstvenog informisanja“ decembar 2017.
3. Vlada Kosova, Ministarstvo zdravlja, Komora zdravstvenih profesionalaca i UKBC da iz rade i pripreme preduslove za Informativni zdravstveni sistem, gde se obuhvataju :
 - a. Lista usluga na svim nivoima zdravstvenog sistema na Kosovu u javnim i privatnim institucijama.
 - b. Kontrola a zatim licenciranje svih zdravstvenih profesionalaca, koji ispunjavaju uslove, u javnom i privatnom sektoru.
 - c. Formiranje državnog registra zdravstvenih radnika u svim javnim i privatnim institucijama.
 - d. Izgradnju sistema referisanja pacijenata
 - e. Izrada i ozvaničene objektivne klinike.
 - f. Državni registar lekova.
4. Skupština Kosova zahteva od Centralne banke Kosova da dostavi najkasnije 60 radnih dana detaljan Izveštaj o finansijama i licenciranih osiguravajućih kompanija, koje pružaju privatno zdravstveno osiguranje .

5. Vlada republike Kosova, na osnovu Izveštaja performanse Generalnog revizora, da naglasi institucijama pravosuđa slučajeve kršenja i finansijske štete zbog ne blagovremenog sprovođenja Projekta informativnog zdravstvenog sistema.

Do-630
Priština, 26.04.2018

Predsednik Skupštine,

Kadri VESELI

Mociju dostaviti:

- Vlade Republike Kosova,
- Parlamentarnim grupama, i
- Arhivi Skupštine.